



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1312/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Adnan Hyseni në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve , për shkak të parregullsive, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa e Adnan Hyseni, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak se e njëjta çështje është gjykuar (res judicata).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë për mesë postës më datë 24.12.2013, nga Adnan Hyseni, në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik AAK, me të cilën pretendon se me datën 03.11.2013, janë bërë shkelje të dispozitave ligjore gjatë procesit zgjedhor në këto Qendra të Votimit 1707 VV 6 dhe 7, QV 1701 VV 1, 3 dhe 5, QV 1704 VV 9 dhe 13, QV 1705 VV 2, 3 dhe 5, QV 1723 VV 2, QV 1713 VV 1 dhe 2, QV 1726 VV 1 dhe 2 si dhe QV 1727 VV 1 dhe 2.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e Adnan Hysenit në cilësinë e Kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik AAK gjeti se:

Për të njëjtën çështje PZAP-i ka vendosur me vendimin Anr.741/2013 të datës 08.11.2013.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e sipërshtuar PZAP-i nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë sepse për këtë çështje PZAP-i ka vendosur me datë 08.11.2013 me vendimin Anr. 741/2013, andaj është konstatuar si çështje e gjykuar (res judicata).

Duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 dhe neni 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 1312/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,